



REPUBLICA KOSOVA
 QYTETI
 NËMË ËSHTË I PLOTFUQISHËM
 DOKUMENTI JE PRAVNOSNAZNA
 KARAR KESINDIR
 TËMELORE / OSNOVNI SUD / ASLIYE MAHKEMESI
 NËMË II PRIZREN - PRIZRENE

16.01.2018 NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti për Krime të Rënda, me kryetarin e trupit gjykues Skender Çoçaj, me procesmbajtësen Birsën Kume-sekretare juridike pranë kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarit I. Sh. nga Prizreni, për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 paragraf 2 të KP, sipas aktakuzës së PTH në Prizren PP/Inr. /2017 të datës 11.12.2017, në seancën e shqyrtimit të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, në prezencën e Prokurorit të Shtetit E. G. të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij avokat N. B. me datë 19.12.2017, mori dhe publikisht shpalli këtë:

AKT GJYKIM

I akuzuari:

I. SH. nga i ati L. dhe e ëma Z. e vajzërisë Sh. i lindur me datën në fshatin komuna e Suharekës, ku edhe jeton, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor, beqar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Se me datë 29.10.2017 rreth orës 10.15 min, pa autorizim transporton substancën narkotike me qëllim të shitjes dhe shpërndarjes, në atë mënyrë që të njëjtën e merr nga një person në R. e Shqipërisë, me qëllim të transportit në Kosovë dhe me rastin e kalimit në kufirin e PPK-së në Vërmicë, me automjetin minibus "Arditi turs", me targa, gjatë kontrollit të i pandehuri (pasagjer i minibusit në fjalë) në njërin nga çantat e tij, nga ana e oficerëve doganor janë gjetur pesë (5) paketime të substancës narkotike të llojit marihuanë e mbështjellë, në peshë rreth 10.625 gram.

Këso dore ka kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 paragraf 2 të KP.

Andaj, gjykata në bazë të dispozitave të lartshënuara dhe neneve 4, 7, 17.1 41, 42, 43, 45, 46, 73 si dhe nenit 273 paragraf 2 të KP, të akuzuarin e:

GJYKON

-Me dënim me gjobë në lartësi prej 2000 (dymijë) eurove, të cilën shumë i akuzuari është i obliguar ta paguajë në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë gjobën dënim me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim me burgim ashtu që për çdo 20 euro të gjobës do t'i llogaritet një ditë burgim dhe,



-Me dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite e 6 (gjashtë) muaj, në të cilin dënim do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 29.10.2017 deri më 19.12.2017.

Në pajtim me dispozitën e nenit 273 paragrafi 5 konfiskohet substanca narkotike e llojit marihuanë në peshë prej 10.625 gram.

I akuzuari Ilir Shahinaj obligohet, që të paguajë shpenzimet e procedurës dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 200 euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Prizren ka paraqitur aktakuzën PP/Inr: [REDAKTUAR] 2017 të datës 11.12.2017, kundër të akuzuarit I [REDAKTUAR] Sh [REDAKTUAR], për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 parag.2 të KP dhe marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë PP/I nr. [REDAKTUAR] /2017 të datës 07.12.2017..

Prokurori i shtetit gjatë seancës për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë ka deklaruar se pas propozimit për negociimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë të parashtruar me shkrim nga ana e mbrojtësit të akuzuarit, kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren e ka autorizuar që ta mbajë takimin për diskutimin për pranimin e fajësisë, si rezultat i këtij diskutimi me të akuzuarin dhe mbrojtësin e tij dhe pas kumtimit të favoreve dhe disfavoreve të lidhjes së marrëveshjes për pranimin e fajësisë, prokurori i shtetit me të akuzuarin me datë 07.12.2017, ka lidhur marrëveshjen për pranimin e fajësisë para ngritjes së aktakuzës. Dënimi i rekomanduar në këtë marrëveshje nga ana e prokurorisë i përmbush të gjitha kushtet ligjore që kërkon përcaktimi i dënimit gjatë arritjes së marrëveshjes për pranimin e fajësisë para se të ngritet aktakuza dhe ka konsideruar se me dënimin me burg dhe me gjobë mund të arrihet qëllimi të cilin e ka dënimi si institut juridik. Andaj i ka propozuar gjykatës që këtë marrëveshje ta pranoj dhe t'ia shqiptojë dënimet e rekomanduar në këtë marrëveshje.

Mbrojtësi i të akuzuarit av. N [REDAKTUAR] B [REDAKTUAR] ka deklaruar se arsyeja që e ka shtyrë të bëjë kërkesën për negociimin e pranimit të fajësisë me prokurorin e shtetit ka qenë fakti se i mbrojturi i tij që nga dhënia e deklaratës në polici por edhe pas dëgjimit në Prokurorinë e shtetit e ka pranuar fajësinë për veprën që ngarkohet, dhe pas kërkesës që e ka bërë me prokurorinë e shtetit kanë arritur që në prokurori ta negociojnë pranimin e fajësisë. Para se të hynte në marrëveshje, të mbrojturin e vet, si mbrojtës i tij e ka këshilluar për pasojat dhe favorret që dalin nga kjo marrëveshje, po ashtu me rastin e nënshkrimit edhe nga prokuroria e shtetit është udhëzuar dhe është pyetur se “a hynë në marrëveshje me vullnetin e tij të lirë” dhe pasi që janë plotësuar kushtet është e vërtet se e kanë nënshkruar marrëveshjen, dhe i ka propozuar gjykatës që të njëjtën ta aprovoj.

I akuzuari I [REDAKTUAR] Sh [REDAKTUAR] ka deklaruar se është konsultuar mjaftueshëm me mbrojtësin e tij me rastin e negociimit dhe lidhjes së marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, e ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale e cila i vihet në barrë gjithashtu se me rastin e lidhjes së marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë ka hequr dorë nga e drejta për gjykim të rregullt, dhe se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar.



Gjykata nën kushtet dhe rrethanat e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Sa i përket gjendjes faktike, gjykata ka vërtetuar ashtu si është përshkruar në dispozitivin e aktakuzës në kushtet dhe rrethanat e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë kështu që gjykata në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari Iliri Shahinaj me datë 29.10.2017 rreth orës 10.15 min, pa autorizim transporton substancën narkotike me qëllim të shitjes dhe shpërndarjes në atë mënyrë që të njëjtën e merr nga një person në R. e Shqipërisë, me qëllim të transportit në Kosovë dhe me rastin e kalimit në kufirin e PPK-së në Vërmicë, me automjetin minibus "Arditi turs", me targa [REDAKTUAR], gjatë kontrollit të pandehuri (pasagjer i minibusit në fjalë) në njërën nga çantat e tija, nga ana e oficerëve doganor janë gjetur pesë (5) paketime të substancës narkotike të llojit marihuanë e mbështjellë, në peshë rreth 10.625 gram.

Pas dëgjimit të pikëpamjeve të prokurorit të shtetit, si dhe të akuzuarit lidhur me marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, gjykata konstatoi se i akuzuari I. Sh. [REDAKTUAR] ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari gjykata ka konstatuar se i akuzuari në asnjë mënyrë nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar ta pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në fakte dhe prova materiale të rastit konkret të cilat janë paraqitur në aktakuzë të pranuar edhe nga i akuzuari dhe se nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat që parashihen në dispozitat e nenit 253 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-së për hudhjen e aktakuzës, prandaj edhe ka vendosur që ta pranojë marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë.

Lidhur me dënimin prokurori i shtetit ka qëndruar në tërësi pranë propozimeve të dhëna marrëveshjen për pranimin e fajësisë.

Mbrojtësi i të akuzuarit lidhur me dënimin ka deklaruar se, sa i përket dënimin të rekomanduar edhe pse e kanë nënshkruar marrëveshjen dhe janë pajtuar me këtë dënim, i ka propozuar gjykatës që me rastin e shqiptimit të dënimin të zbus në suazat e mundësive ligjore që i ka dënimin, pasi që i mbrojturi i tij që në fillim e ka pranuar fajësinë, nuk ka evidencë në të kaluarën kriminale, është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin, është penduar dhe ka premtuar se në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm që të mos bie ndesh me ligjin, ka propozuar që t'i ndërpritet masa e paraburgimit ngase e konsideron se kanë pushuar arsyet për të cilat është caktuar, këtë e ka thënë pasi që i akuzuari pritët që të fejojët së shpejti.

I akuzuari I. Sh. [REDAKTUAR] lidhur me dënimin ka deklaruar se në tërësi pajtohet me fjalët e mbrojtësit të tij.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenies së veprave penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin të shpall fajtor dhe të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimin gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara sipë në nenin 73 të KPP të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimin. Si rrethanë posaçërisht lehtësuese



gjkata mori pranimin e fajësisë sipas marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit, se është i moshës së re, është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin, se në gjykim ka pasur qëndrim tejet korrekt. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar si në diapozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 i KP dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon akuzuari.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 450, dhe 453 paragrafi 1 të KPP-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

P.nr. 124/17 me datë 19.12.2017

**Procesmbajtësja
Birsen Kume**



UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë nëpërmjet kësaj Gjykate, përveç për shkak të vërtetimit të plotë dhe jo të drejtë të gjendjes faktike dhe vendimit mbi dënimin.